VENDIM
Nr.1533, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË PESHKOPI TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Peshkopi të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1445 (një mijë e katërqind e dyzet e pesë).

2. Ngarkohen Ministri e Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Peshkopisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Peshkopi Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4,7-35	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
59	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
64-84,86-91	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
152-154	Varreza publike	Në pronësi
98	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	
141-143,155-172,188,189,196,201,202,242-248,363,592-662,666,828	Infrastrukturë (troje të lira).	Në përdorim
151,173-187,190-195,197-200,203-241,249-362,364-591,746,752,755,1114-1333	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
148-150,668,673-675,677,721,732-753,755-762,772-	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi

777,819,820,822,823,826-828, 839,840,842,878-884,909,910 1432		
979-994	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (prona të bujqësisë).	Në pronësi
127,132,136,137,139,140	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
911-978	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
1424-1431,1433-1445	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim